



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 67, Datë 16/03/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 154, datë 21.11.2017, e Z. A. P.dhe Znj. M. L., ku pretendohet për diskriminim të tyre, për shkak të “orientimit seksual” dhe “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Z. B. L., mjek i Urgjencës së Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se në datën 02.10.2017, Z. A. P.me nënën e tij, Znj. M. L. janë paraqitur për të marrë ndihmë mjekësore pranë Shërbimit të Urgjencës së Spitalit Universitar të Traumës, në Tiranë. Ankuesi pretendon se kishte nevojë për oksigjen nga problemet me mushkëritë, ndërkohë që nëna e tij ishte me virozë. Z. A. P.thekson faktin se janë paraqitur rreth orës 19:00, pranë këtij spitali dhe pas orës 20:00, u është ofruar shërbimi dhe ndihma mjekësore. Për sa më sipër, Z. A. P.thekson faktin se ishte shumë i

shqetësuar për çdo minutë që kalonte, sidomos për gjendjen e nënës së tij, e cila ishte me tension të lartë, por njëkohësisht edhe për veten e tij, pasi kishte nevojë për oksigjen. Ankuesi shprehet se ndihet i diskriminuar për shkak të orientimit të tij seksual, nga sjellja e mjekëve të këtij spitali dhe nëna e tij ndihet e diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, po nga të njëjtët mjekë, që nuk ia kishin ofruar në kohë shërbimin mjekësor.

Me qëllim marrjen e një informacioni më të specifikuar rreth subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa, si dhe për të siguruar të dhëna të tjera, të nevojshme, në kuadër të shqyrtimit të ankesës, në datën 04.12.2017, strukturat përgjegjëse të Komisionerit u takuan me të dy ankuesit. Gjatë këtij takimi, Z. A. P. sqaroi se ankesa e tij drejtohej ndaj mjekut B. L., i cili ishte në shërbim urgjence, pasditen e datës 02.10.2017, pranë Spitalit Universitar të Traumës (SUT), Tiranë. Z. A. P. ritheksoi edhe një herë faktin se ishte paraqitur pranë këtij spitali në orën 19:00 dhe shërbimi mjekësor u ishte dhënë 1 orë me vonesë dhe se e gjithë kjo vonese kishte ndodhur se ishte diskriminuar për shkak të orientimit të tij seksual dhe aftësisë së kufizuar të nënës së tij. Ankuesit u shprehën se ishin vizituar nga mjeku B. L., i cili pas dhënies së ndihmës së parë mjekësore, i kishte drejtuar për në QSUT. Znj. M. L. iu kërkua një vërtetim apo çdo lloj akti tjetër, të lëshuar nga KMCAP, ku të vërtetohej aftësia e saj e kufizuar. Ankuesja u shpreh se nuk kishte asnjë akt, apo dokument të tillë dhe se vuante nga osteoporoza. Ndërkohë që Z. A. P. u shpreh se i përkiste komunitetit LGBT, duke depozituar pranë Komisionerit dokumentacionin provues për sa më sipër.

- Pas vlerësimit fillestar të ankesës së Znj. M. L., Komisioneri gjykoi se në mungesë të një akti/vërtetimi të KMCAP, ku të vërtetohej se Znj. M. L. ishte me aftësi të kufizuara, pra në mungesë të një shkakut diskriminimi të vërtetuar dhe të provuar shkresërisht, duke iu referuar nenit 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, ankesa e saj nuk mund të pranohet për shqyrtim, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim. Ndërkohë që, për pjesën e ankesës, që i përket Z. A. P., Komisioneri ndoqi procedurat ligjore për shqyrtimin e saj.

“Orientimi seksual” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën,

¹Në nenin 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikohet shprehimisht: “Ankesa nuk pranohet nëse:ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”.

gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

✚ Nëpërmjet shkresës nr. 1139/1 Prot., datë 14.12.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi mjekun B. L., mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi.

- Mjeku endokrinolog në SUT, Z. B. L. iu përgjigj shkresës së Komisionerit duke dhënë sqarimet përkatëse mbi pretendimet e Z. A. P. Z. B. L. e bën me dije Komisionerin, se Z. A. P. është paraqitur pranë Spitalit Universitar të Traumës (SUT), në datën 02.10.2017, në gjendje helmimi ushqimor dhe ndaj tij është zbatuar terapia përkatëse, që zakonisht ndiqet në raste analoge. Në vijim, ankuesi është sqaruar, se pas dhënies së kësaj ndihme, ai dukej të paraqitej në Urgjencën e Spitalit Infektiv, pranë QSUT. Z. B. L. shprehet se nuk kishte asnjë dijeni mbi prirjet dhe orientimin seksual të Z. A. P. dhe se ai kishte kryer detyrën e tij. Ndaj Z. A. P. ishte kryer terapia përkatëse.

✚ Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhërit nr. 193, datë 29.12.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u krye inspektim pranë Spitalit Universitar të Traumës (SUT).

Në inspektimin e kryer, inspektorët e Komisionerit u takuan me Z. B. L., i cili edhe një herë dha sqarimet përktëse mbi pretendimet e Z. A. P. Ai u shpreh se Z. A. P. dhe nëna e tij janë paraqitur pranë Shërbimit të Urgjencës, së Spitalit Universitar të Traumës, në orën 19:05, në datën 02.10.2017. Mjeku thekson faktin se të dy pacientët janë diagnostikuar me helmim ushqimor dhe ndihma u është ofruar menjëherë. Z. B. L. thekson faktin se në datën 02.10.2017, ai ka qenë në shërbimin e rojes pranë Urgjencës, ndërkohë që ai është mjek specialist pranë SUT-s. Mjeku i ka këshilluar të dy pacientët, pas dhënies e ndihmës mjekësore, që nëse ndiheshin mirë mund të ktheheshin në shtëpi, ose nëse do të kishin problem në vijim të paraqitëshin për ndihmë pranë QSUT. Mjeku B. L. thekson faktin se në Urgjencën e këtij Spitali, shërbimi u ofrohet në mënyrë të njëjtë të gjithë individëve pa asnjë lloj diskriminimi. Inspektorët morën në cilësinë e provës kopje të regjistrit të muajit tetor 2017, ku rezultonte momenti i paraqitjes në spital të pacientëve dhe dhënia e ndihmës mjekësore përkatëse. Në këtë regjistër nuk reflektohej orari i dhënies së ndihmës mjekësore. Mjeku theksoi faktin se ndihma mjekësore u është dhënë në mënyrë të

menjëherëshme. Z. B. L. u shpreh sërish se nuk kishte dijeni mbi orientimin seksual të ankuesit dhe e përjashton kategorikisht diskriminimin e tij për këtë shkak.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Në datën 02.10.2017, Z. A. P. dhe nëna e tij, Znj. M. L. janë paraqitur pranë Shërbimit të Urgjencës, së Spitalit Universitar të Traumës. Referuar recetave dhe akteve të dorëzuar nga ankuesi në cilësinë e provës, si dhe duke iu referuar Regjistrin të Urgjencës² (pjesa e terapisë), për datën 02.10.2017, rezulton se ankuesit janë regjistruar në këtë regjistër me emrat T. P. dhe M. L. dhe diagnoza e tyre është helmim ushqimor. Referuar po të njëjtit regjistër, rezulton se ora e paraqitjes së ankuesve pranë Shërbimit të Urgjencës ka qenë 19:05, ndërkohë që nuk reflektohet orari, në të cilin ankuesit A. P. dhe nënës së tij u është dhënë ndihma mjekësore. Nëse do të mbështetemi tek provat e depozituara nga ankuesi dhe përkatësisht, njëres prej recetave mjekësore, të lëshuara nga ana e mjekut B. L., në datën 02.10.2017 për nënën e ankuesit, e diagnostikuar me intoksikacion ose helmim ushqimor, rezulton se ora e shënuar në fund të recetës, që përkon me momentin e lëshimit të kësaj recete, është 19:00. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se mjeku ka shënuar në recetë kohën e përafërt të dhënies së ndihmës mjekësore, e cila në bazë të provave të sipërpërmendura, përkon përafërsisht me momentin e paraqitjes së ankuesve pranë Urgjencës së Spitalit.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, në mungesë të provave të tjera, që të mund të provojnë të kundërtën, Komisioneri gjykon se Z. A. P. nuk i është nënshtruar apo është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e mjekut B. L.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi para një situatë diskriminuese për Z. A. P.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), si dhe nenin 33, pikat 1 dhe 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

² Emri i ankuesit në Regjistrin e Urgjencës së Spitalit Universitar të Traumës është shënuar Titi Plasa. I njëjti emër rezulton të jetë shënuar edhe në recetat mjekësore të dorëzuara nga ankuesi në cilësinë e provës pranë Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “orientimit seksual”, të Z. A. P., nga ana e Z. B. L., mjek pranë Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë.
2. Mospranimin e ankesës së Znj. M. L., pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU
KOMISIONERI

(Shkak - orientimi seksual dhe aftësia e kufizuar
Fusha: të mira dhe shërbime)